

VENDIM QARKULLUES

Nr. 26, datë 8.4.2020

PËR HEQJEN E KOMISIONEVE TË APLIKUARA NGA BANKAT PËR TRANSFERTAT E KREDITIT NË FORMË JO LETËR PËR KLIENTËT E TYRE, SI DHE TË TARIFAVE PËR PJESËMARRËSIT BANKA NË SISTEMET E PAGESAVE AIPS DHE AECH TË OPERUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, të nenit 21, pikat 1 dhe 4, të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 129, pika 6, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 15 të ligjit nr. 133/2013, “Për sistemin e pagesave”, me propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij vendimi deri më 30 qershor 2020, në përjashtim të parashikimeve të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 53, datë 26.9.2007, “Për miratimin e rregullores ‘Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS’”, të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 55, datë 26.9.2007, “Për miratimin e rregullores ‘Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)’”, të ndryshuar:

a) Bankat të mos aplikojnë komisione bankare për llogari të klientëve të tyre, për transfertat e kreditit në lekë, në formë jo letër, të kleruara dhe të shlyera në sistemet e pagesave AIPS dhe AECH nga bankat pjesëmarrëse në këto sisteme.

b) Banka e Shqipërisë nuk do të aplikojë asnjë tarifë për transaksion, kundrejt bankave pjesëmarrëse në sistemet e pagesave AIPS dhe AECH, për të gjitha pagesat në lekë të transmetuara nga bankat pjesëmarrëse në këto sisteme.

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen bankat, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Departamenti i Mbikëqyrjes, si dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në Bankën e Shqipërisë.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e tij në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 10.4.2020 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Gent Sejko**